



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1116/3 Prot.

Tiranë, më 10 . 08 . 2021

V E N D I M

Nr. 148 , Datë 10 . 08 . 2021

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 153, datë 06.08.2021, të paraqitur nga S.V kundër Shoqërisë Albpetrol sh.a, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes ekonomike”, “moshës” dhe “gjendjes shëndetësore”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, ankuesi në mes të tjerash informon se: “Nga data 26.10.1999 deri në datë 31.10.2018 ka punuar në pozicione të ndryshme pranë Albpetrol sh.a. Së fundi ka punuar në Qendrën e Furnizimit dhe Shërbimeve Elektrike, në pozicionin si ekonomist sektori. Me shkresën nr. 6402, datë 23.07.2018 është njoftuar mbi ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të pushimit kolektiv, dhe me shkresën nr. 10615, datë 31.10.2018 është njohur me Vendimin nr. 947, datë 31.10.2018, mbi ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të ristrukturimit organizativ. Ankuesi informon se për largimin e tij nga puna nuk janë zbatuar procedurat e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës. Ankuesi shpjegon se ka pasur vjetërsi në punë më shumë se punonjësit e tjerë, ka qenë më i moshuari, ka arsim të lartë dhe ka qenë në gjendje jo të mirë shëndetësore”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe dëmshpërblim për pasojat e ardhura atij dhe familjes së tij.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: a) shfuqizuar; b) përbën abuzim me të drejtën e ankimimit para komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji; c) e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një ankese tjetër ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja; ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim; d) të gjitha faktet që përbëjnë thelbin e ankesës kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të këtij ligji; dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijani për sjelljen diskriminuese”, Komisioneri vlerëson se, ankesa nuk duhet të pranohet, pasi është paraqitur përtej afateve ligjore të parashikuara nga germa “dh”, e pikës 4, të dispozitës ligjore të sipërcituar, bazuar në arsyetimin vijues:

Së pari, formulimi në nenin 33, pika 4, germa “dh”, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikon se afati maksimal 3 vjeçar, nga momenti i ndodhjes së diskriminimit dhe afati maksimal 2 vjeçar, nga momenti i marrjes dijani për diskriminimin, nuk janë afate kumulative. Për t’u konsideruar brenda afateve ligjore për shqyrtimin e ankesave nga ana e Komisionerit, ankuesi mund të provojë ose se, nuk kanë kaluar 3 vjet nga ndodhja e diskriminimit, pavarësisht se kur ka marrë dijani, ose në rast se provon se momenti i marrjes dijani është i ndryshëm nga momenti i ndodhjes së diskriminimit, ankuesi është brenda 2 viteve nga marrja dijani.

Së dyti, fakti diskriminues i pretenduar nga ankuesi, sikundër shprehet edhe ai vetë në ankesë, rezulton të ketë ndodhur në datë 31.10.2018, datë në të cilën ankuesi ka marrë vendimin për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, bazuar në shkresën nr. 10615, datë 31.10.2018, të Administratorit të Shoqërisë Albpetrol sh.a.

Referuar shprehimeve të dhëna nga ankuesi dhe kohën që ai ka identifikuar se kur ka marrë dijani për diskriminimin e pretenduar, rezulton se ankuesi ka marrë dijani në datën 01.11.2018. Në lidhje me momentin e marrjes dijani, bazuar në aktet e administruara, rezulton e provuar se, ankuesi ka marrë dijani për faktin e pretenduar si diskriminues, pra të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, në datën 01.11.2018. Pra, rezulton se jemi në kushtet, që momenti kur ka ndodhur diskriminimi i pretenduar është i njëjtë me momentin e marrjes dijani.

Fakti i pretenduar si diskriminues ka ndodhur në datën **31.10.2018**, ankuesi ka marrë dijani për diskriminimit e pretenduar ditën e nesërme dhe ka paraqitur ankesën pranë Komisionerit në datën **06.08.2021**, pra në tejkalim të afateve të parashikuara në neni 33, pika 4, germa “dh”, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, lidhur me sa sipërcituar, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk përmbushet kriteri ligjor për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga neni 33, pika 4, germa “dh”, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar dhe për

rrjedhje ankese nuk mund të pranohet për t'iu nënshtruar procedurave të mëtejshme nga ana e Komisionerit.

Sa më sipër, sjellim në vëmendje se ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 34, në pikën 2 të tij, parashikon se: “Paraqitja e ankimit përpara Komisionerit nuk është kusht për të paraqitur një kërkesëpadi dhe nuk përbën pengesë për personin e dëmtuar t’i drejtohet gjykatës”.

Nga ana tjetër, ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 36, pika 1 të tij, parashikon se: “Padia i paraqitet gjykatës kompetente nga një prej subjekteve të parashikuara në nenin 34 të këtij ligji jo më vonë se 5 vjet nga dita kur ka ndodhur sjellja e pretenduar diskriminuese dhe jo më vonë se 3 vjet nga dita kur i dëmtuari merr dijeni për këtë sjellje”.

Duke qenë se subjekti ankues është brenda afateve të parashikuara në këtë Ligj¹, për të ndjekur gjyqësisht pretendimin e tij për diskriminim, Komisioneri i rekomandon që t’i drejtohet gjykatës kompetente.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “dh” të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës nr. 153, datë 06.08.2021, të paraqitur nga S.V kundër Shoqërisë Albpetrol sh.a, pasi është paraqitur tej afateve ligjore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

¹ Neni 36 i Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar: “Procedura para gjykatës”.